

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-214/14

**Prishtinë,
5 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

L.V.Z.

Kolonija, Djurdjevo
35000 Jagodina
Serbia

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

kundër

Komuna e I.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarë: Sylejman Nuredini, Kryetare e Kolegjit , Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/233/2014 (kërkesa e regjistruar në AKP me numrin KPA25479) i datës 13 mars 2014, pas seancës së mbajtur më 6 Tetor 2016 mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e L.Z. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/233/2014 i datës 13 mars 2014 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA 25479.**
- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/233/2014 i datës 13 mars 2014 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA 25479.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 27 prill 2007, L.V.Z. ka paraqitur një kërkesë në cilësinë e titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) me të cilën ka kërkuar ri posedimin e pronës-lokalit afarist. Ajo pretendon se, me aktvendimin e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal I. nr.01-463-379 i dt. 15 prill 1991 i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm pjesa e ngastrës nr. 1779/2 në sipërfaqe prej 20². Sipas raportit të verifikimit i dt.08.korrik 2008, ky aktvendim është verifikuar pozitivisht.
2. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër KPA25479.
3. Posedimin e këtij objekti komercial e ka humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998/99 ,duke cekur datën e humbjes me 24 qershor 1999.
4. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo e parashtroi Kontratë e lidhur me15 nëntor 1991 në mes të Kuvendit Komunal I. dhe paraqitëses së kërkesës lidhur me shfrytëzimin e përkohshëm të ngastrës që është objekt i kësaj kërkesë. Sipas paragrafit një të kësaj kontrate paraqitësi i kërkesës ka pasur të drejtë që pjesën e kësaj ngastre në sipërfaqe prej 20² ta shfrytëzon përkohësisht dhe po ashtë sipas kërkesës së organit kompetent ta mënjanon atë objekt me shpenzimet e tij.
5. Sipas fletës poseduese nr.828 nr. 08 korrik 2008 të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ngastra nr. 1776/2 është evidentuar si tip i pronës shoqërore të Komunës së I. . Ky dokument është verifikuar pozitivisht.

6. Më 31 maj 2011,zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti afarist- kioska dhe konstatuan që objekti ishte në shfrytëzim të Kuvendit Komunal të I. J.B., përfaqësues i Kuvendit Komunal të I. ka pretenduar të drejtë ligjore për këtë pronë duke theksuar se prona është e tipit të pronës shoqërore. Me rastin e notifikimit është konstatuar që ky objekt është i tipit montazh dhe i përkohshëm.
7. Më 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPPC/D/C/233/2014 ,e hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. KPCC në arsyetim e vendimit ankimor ka konkluduar se titullari i të drejtës pronësore-kërkuesi i objektit komercial ka përfituar vetëm të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit dhe rrjedhimisht ka qenë i autorizuar për të ndërtuar një objekt i tipit montazh i karakterit të përkohshëm që cilësohet si pronë e luajtshme.
8. Prandaj, prona e kërkuar duhej të konsiderohej si një objekt i luajtshme sipas nenit 9 te Ligjit të Pronësisë dhe te Drejtave tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154). Ndërkaq sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC nuk kishte kompetenca për të vendosur vetëm për pronat e luajtshme.
9. Me dt.20 maj 2014,pala ankuese pranoi vendimin e KPPC/D/C/233/2014 i datës 13 mars 2014 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA 25479,dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 12 qershor 2014 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).

Pretendimet e palës ankuese

10. Ankuesi shpjegoi që vendimi ankimor nuk është formuluar qartë dhe nuk përmban shpjegim e bazës ligjore dhe faktike të tij. Prandaj, vendimi i organit i KPCC bazohet me vërtetim jo të plotë të fakteve dhe vlerësim të gabuar të tyre. Po kështu, vendimi ankimor është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Pala ankuese pretendon se objekti afarist është ndërtuar me material të fort sipas projektit të organit përkatës .Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta rishikojë vendimin dhe t'i pranoj të drejtat e palës ankuese për kthim dhe shfrytëzimin e pronës si pronar i ligjshëm i sajë.

Arsyetimi ligjor:

11. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
12. Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore, sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës, Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar
13. KKPK-ja ka bërë vlerësimin e saktë të dëshmimeve kur ka vendosur që kërkesa nuk është brenda fushëveprimit të saj. KKPK ka dhënë shpjegime dhe sqarime të drejta të plota, të kuptueshme, të qarta, të sakta dhe rrjedhimisht të ligjshme për faktet vendimtare për një vendim të drejtë.
14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon të drejtën pronësore, ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se, juridiksioni i Komisionit për kërkesa pronësore i AKP-ës dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme është i kufizuar ekskluzivisht për zgjidhjen, gjykimin dhe vendosjen e kërkesave të së drejtës së pronësisë për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.
15. Nuk është kontestuese se me Aktvendimin e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal I. nr.01-463-379 i dt. 15 prill 1991 paraqitësit të kërkesës- palës ankuese i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin e barakës të tipit montazh që gjendet në pjesën e ngastrës nr. 1779/2 në sipërfaqe prej 20²
16. Prandaj, nga kjo gjendje e konstatimeve faktike Gjykata Supreme vlerëson se, i drejtë dhe i ligjshëm është vendimi ankimor i Komisionit për Kërkesa Pronësore kur ka vendosur që të hedhet i palejueshme kërkesa e palës ankuese për mungesë të kompetencës, për shkak se sipas këtij aktgjykimi prona që është objekt i kërkesës është i tipit barakë – montazh që trajtohet si send i luajtshëm.
17. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se, prona e kërkuar sipas dispozitës së nenit 9 par1 të Ligjit për Pronësi dhe Drejtat tjera Sendore, trajtohet send i luajtshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se ndërtesat e përkohshme të ndërtuar në tokën ndërtimore të dhënë përkohësisht në shfrytëzim, siç është rasti konkret nuk konsiderohen sende të paluajtshme. Për më tepër sipas nenit 14 par.1 dhe nenit 26 par.2 të Ligjit për Tokën Ndërtimore Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 14/80 parashikon kur

organi kompetent e jep në shfrytëzim të përkohshëm për nevojat e përkohshme kërkuesve për vendosjen objekteve të përkohshme i tipit montazh, atëherë ai organi ka të drejtë që sipas nevojave të planit urbanistik ta dislokoj atë objekt me shpenzimet personale të shfrytëzuesit. Madje, objekti i përkohshëm nuk mund të jetë çështje e pranimit të drejtës së pronës e as që mund të regjistrohet në regjistrin e pronësisë së zyrës për kadastër.

18. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit se ,vendimi ankimor nuk është formuluar qartë dhe nuk përmban shpjegim e bazës ligjore dhe faktike të tijë dhe objekti afarist është ndërtuar me material, por gjeti se këto pretendime ishin të pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht të kundërligjshme .Kjo pikërisht për arsye se, vendimi ankimor është formuluar qartë dhe përmban shpjegime të qarta, të plota, të kuptueshme të bazës ligjore dhe faktike të tijë, për aq sa është e nevojshme për një vendim të natyrës procedurale- vendimmarrjes për shkak të mungesës së juridiksionit. Përpos kësaj objekti afarist ka qene i parapare të ndërtohet i tipit montazh ndaj edhe injorimi i këtyre normave ligjore nuk mund të ketë mbrojtjeje gjyqësore.
19. Gjykata Supreme i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike. Madje, ai as që ka paraqitur dëshmi juridikisht të vlefshme për t'i mbështetur ato pretendime.
20. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale .Po kështu ky vendim nuk bazohet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ,siç pretendon ankuesi.
21. Ky aktgjykim nuk përjashton dhe kufizon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij në gjykatat kompetente.
22. Rrjedhimisht mbi të më sipërmen e me aplikim të ligjit (neni 13.3.C i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

23. Këshillë ligjore:

24. Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Kryetari i Kolegjit, Sylejman Nuredini,

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Referente e EULEX-it, Sandra Gudaityte